

## LITERATURE AND INTERNET LETËRSIA DHE INTERNETI

**Ariana LUKAJ<sup>1</sup>, Rajmonda BERISHA<sup>2</sup>**

<sup>1</sup> Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina“

<sup>2</sup> Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina“

\*Corresponding author e-mail: ariana.lukaj@rks-gov.net, rajmondaberisha89@hotmail.com

Në ditët e sotme në kuadër të kushteve të nevojshme për jetesë bën pjesë edhe interneti, periudhë kohe, e cila lidhet me një ngjarje të madhe a me një kthesë të rëndësishme në zhvillimin e diçkaje. Në tregun e literaturës, një ndikim të padiskutueshëm ka luajtur edhe interneti, nga i cili, libra të shumtë mund të shkarkohen dhe lexohen përmes ekranit. Por kompjuteri dhe libri dallojnë shumë. Libri në kompjuter është shumë i vështirë të lexohet.

Sot, kemi mundësi të mëdha, që të komunikojmë me gjithë botën. Mund të themi se kemi përballë një veprimtari, që synon të marrë a të japë njoftime e të dhëna për dikë a për diçka, që kërkon shumë mund, përpjekje e punë për ta bërë, për ta kryer, për ta zgjidhur a për ta mësuar, jap mendim për dikë a për diçka, përcaktoj rëndësinë, dobinë ose vlerën shoqërore të dikujt a të diçkaje.

Është bërë pjesë e madhe e një vendi, që dallohet sipas disa tipareve të veçanta, jep me shumicë informacion, ku informacioni përshkon një largësi jashtëzakonisht të madhe për një periudhë kohe shumë të shkurtër, brenda së cilës kryhet diçka në çast, sasi shumë e madhe, por e përcaktuar saktë. Sot, letërsia, leximi në përgjithësi ka marrë kahje tjetër, sepse të dhënat, që i kemi përpara në kompjuter kanë marrë pamje të tjera, në krahasim me leximin në libër, letër etj

Në këtë mënyrë kanë filluar të ndryshojnë rregullat e leximit e të studimit, të cilat kanë arritur nëpërmjet procesit të njohjes e të pasqyimit të botës, shkalla e dijes e arritur me anën e të menduarit p.sh. fakt, ngjarje etj., që shërbejnë për të treguar diçka që na bjen të njohim e të zbulojmë diçka tjetër me të cilën është e lidhur, dëshmi, që na lejojnë të kuptojmë natyrën, a gjendjen e vërtetë të njeriut, e vë në merak e bëjnë të mos e ndjejë veten të qetë, sepse ka ardhur një kohë, që njeriu para kompjuterit zhytet thellë në diçka e nuk di çfarë bëhet përreth tij.

Veprat shkencore, mësimore, letrare etj., me fletë të shtypura e të lidhura së bashku në një vëllim, tërësia e veprave të shkruara në një nga fushat e dijes, artit, pra është më e lehtë për të gjithë të lexojnë një përmbledhje të një libri në internet, sepse nuk janë të përgatitur për t’iu kapur librit me fleta, sepse është krijuar një lakmi e pashuar dhe pajisemi shumë lehtë me informacionet, të cilat na interesojnë në internet dhe i marrim njoftimet e nevojshme me të dhënat e kërkua.

Ky është një realitet, të cilin e gjejmë edhe në sistemin e dijeve, e njohurive për ligjet e zhvillimit të natyrës e të shoqërisë, i cili është formuar historikisht duke vëzhguar botën reale, jetën dhe duke bërë përgjithësime teorike. Të njëjtin mendim duhet ta kenë edhe ata, të cilët kanë aftësi të mëdha mendore, krijuese dhe merren me probleme të thella të natyrës, shoqërisë njerëzore, diturisë, por edhe ata, të cilët, po bëjnë kërkime në ndonjë lëmi të shkencës.

“Mendja ime tani pret, që të marrë informacionin në mënyrën e njëjtë, siç e shpërndan rrjeti atë, në rrjedhën e shpejtë të lëvizjes së grimcave”.<sup>28</sup> Çdo ditë, po vazhdojnë ndryshimet, përmirësimet, rregullimet, që i bëhen diçkaje duke ia ndryshuar gjendjen e mëparshme dhe kjo situatë është pasojë, që vjen nga një shkak, i cili ka të bëjë me veçoritë psikike të një njeriu, apo të një grupi njerëzish, të cilët grumbullojnë diçka për ta përdorur më vonë për arsye të tjera, nxjerr shpejtë një prodhim duke e përpunuar, ose duke shfrytëzuar diçka, që kërkon pak mund, që arrihet e bëhet dhe kalohet pa vështirësi të mëdha, ku sigurohen menjëherë njohuritë e para e fillestare të një fushe të dijes, artit, teknikes etj., pra është e domosdoshme për të plotësuar kërkesat e jetës së përditshme ose shoqërore, diçka e domosdoshme, pa të cilën nuk mund të bëhet, po ashtu është shumë i nevojshëm një fjalor për rrjete sociale për termat më të përdorur në rrjete sociale dhe të arrijmë të domethënia e hollësishme e secilit term p.sh. emoji, hashtag, like, meme, post, replay, tag etj.

Leximi i një libri në dorë, në krahasim me leximin e një përmbledhje të një libri në internet kanë dallime shumë të mëdha, sepse nëse e marrim një libër dhe e lexojmë me vëmendje të plotë atë edhe e përfjethë, ndërsa kur jemi të përmbledhjet, që i gjejmë në internet i lexojmë shumë ftohtë dhe e marrim vetëm informacionin, i cili na intereson dhe si të tillë e paraqesim para të tjerëve. Nevojitet një rrahje mendimesh ndërmjet dy a më shumë vetave rreth çështjes së letërsisë dhe internetit, në përputhje me rregullat dhe normat e vendosura nga shoqëria, duke e përçarur të shoqëria njerëzore e një vendi ose e disa vendeve dhe të organizohet, sipas një rendi të caktuar, që dallohet nga tipare historike e kulturore të veçanta.

Kemi filluar të mos lexojmë libra, prandaj na është krijuar një prirje për të mos lexuar, duke ju shmangur leximit dalëngadalë, po i largohemi mendjes, pa arsye e pa gjykim, po i largohemi intelektit dhe po kalojmë në një gjendje të pafuqishme, të paqëndrueshme, të pakëndshme dhe në këtë mënyrë njeriu, po harron të bëhet bartës i të menduarit, me aftësi mendore, në një gjendje a në një shkallë të caktuar. Shkoqitja e fjalëve të shkruara në letër a diku tjetër, duke i shqiptuar me zë mbahen e ruhen për një kohë të gjatë në mendjen tone p.sh. te një vepër e shkruar në të cilën është shqyrtuar një çështje a paraqiten të dhënat, që janë mbledhur nga kërkimet për një çështje, gjurmime, gjetje ose arritje shkencore.

Arrijmë në një përfundim duke gjetur ngjashmëritë, që kanë ose dukuritë e ndryshme në tërësi, ose disa tipare dhe arrijmë të konceptet, që pasqyrojnë në ndërgjegjen e njeriut, një send, dukuri, marrëdhënie a tipar të përgjithshëm në procesin e njohjes së realitetit. Të gjithë ne, që merremi me letërsi duhet të kemi synim kryesor të përgatitemi edhe më shumë për të ardhmen, që është në të mirën dhe dobinë e të gjithëve, aftësive dhe prirjeve për të kuptuar dhe për të vlerësuar të bukurën dhe artin në jetë dhe të pranojmë mendimet, vlerësimet, që na i japin të tjerët dhe në këtë mënyrë të arrijmë të depërtojmë jashtë kufijeve dhe letërsia jonë të lexohet në internet nga popujt e ndryshëm në botë.

Pasqyrimi në përgjithësi i anës së jashtme dhe të brendshme, që e pasqyron jetën nëpërmjet figurave artistike arrijmë deri te përshkrimi i shkurtër i fakteve e ngjarjeve të jetuara e të para drejtpërdrejtë nga autori, që paraqiten me një stil të thjeshtë e të rrjedhshëm. Prandaj, duhet të marrim një varg veprimesh të veçanta e të lidhura njëra me tjetrën, që bëhen në mënyrë të vetëdijshme për të arritur të një përfundim i caktuar

Letërsia në Kosovë, ka filluar viteve të fundit të krijojë një pasuri shpirtërore, pikëpamje, zakone, por duhet të synojmë edhe më shumë, që t'i kalojmë hapësirat multi-kontinentale. Interneti si shpikje gjeniale e shekullit, i ka ndihmuar artit, shkencës, enciklopedive të popujve të botës, në përhapjen e informacionit, komunikimit, hulumtimit, ueb faqeve me libra të vjetër, bibliotekave elektronike, etj. Pasi që interneti është produkt i një teknologjie shumë të përparuar, me anë të të cilit japim dhe marrim informacione, me shpejtësi dhe lehtësi, në fund të fundit ai i ka të dy anët e medaljes.

---

<sup>28</sup> Mc.Luhan, Marshall, (1962), The Gutenberg Galaxy, University of Toronto Press, Printed in Canada, Reprinted, 1962, fq.162

Në ditët e sotme, mendimet tona, sa u përket librave në përgjithësi, po na dërgojnë të gërshetimi i rrethanave lehtësuese. Në Kosovë, menjëherë pasluftës leximit të librave ka filluar t'ju bie rëndësia dhe kanë marrë një formë tjetër "aq të mirë" për gjeneratat e reja, të cilët e gjejnë librin dhe e interpretojnë si pavetëdije e në mënyrë mekanike. Secili prej nesh, nese e merr një libër dhe ulemi diku në natyrë, në qetësi dhe fillojmë të lexojmë, marrim direct një elektricitet të përbërë nga një rrymë protonesh, të cilat ndikojnë direct në disponimin tonë, prandaj kemi marrë si shembull leximin direkt dhe interpretimin e librit "Hija e maleve" të Ernest Koliqit.

Titulli i librit me tregime "Hija e maleve" na lidh me jetën e Malësisë dhe me banorët e saj. *"Kanuni apo Kodi i Maleve, i mbetur larg vëmendjes së të huajve, ndryn në vetvete norma juridike të stërlashta, të afta të qeverisin në mënyrë të mahnitshme jetën e një shoqërie heroiko-patriarkale"*.<sup>29</sup> Kush qëndron në hijen e këtyre maleve dhe çfarë ndodh në këto male do ta kuptojmë në vazhdim. Libri me tregime "Hija e maleve" ngërthen në vete dymbëdhjetë tregime. *"Koliqi, jo rrallë, në tregimet e veta, sidomos në përmbledhjen e tregimeve "Hija e maleve", shfrytëzon lëndën nga krijimtaria popullore apo kodi kanunor i Lekë Dukagjinit, ku në mënyrë afirmative mishërohen karakteristikat themelore të antropologjisë së botës shqiptare, karakteristikat e botës së arketipave dhe prototipave"*.<sup>30</sup>

Tregimet e librit "Hija e maleve" janë: Nusja e mrekullueshme, Gjaku, Kanga e re, Se qofsh, pleqnofsh, Kërcimtarja e Dukagjinit, Miku, Andërr e një mbasditje vere, Kur orët lajmojnë, Kopshti, Ke tre lisat, Diloca dhe Zana e fundme. Koliqi në librin "Hija e maleve" ka trajtuar tema, që kanë në themel të tyre moralin e Malësisë dhe tragjizmin e jetës së saj në ndeshje me jetën dhe mentalitetin qytetarë të Shkodrës. Karakteristikë e stilit të Koliqit është gjurmimi në thellësitë psikologjike të njeriut, i cili jepet midis mëdyshjeve të kushtëzimeve patriarkale dhe shndërrimeve të reja. *"Kërkesa themelore e Koliqit në tregim është gjurmimi në thellësitë psikologjike të njeriut në lidhjen e tij me ambientin dhe në kushtëzimet morale me kodin malësor apo me rrethanat e shndërrimeve"*.<sup>31</sup>

Duhet të theksojmë, se Koliqi i quan novela tregimet e veta, duke i emërtuar sipas terminologjisë italiane, që ndryshon nga tradita jonë, ku novela i përgjigjet një lloji më të gjatë proze, por e vetmja prozë, e cila i afrohet përdorimit tonë të termit novelë është novela Gjaku. Në secilën prej novelave trajton tema të ndryshme, por tema kryesore, që tërheq vëmendjen në librin "Hija e maleve" është tema e hakmarrjes, pra marrja e gjakut. *"Ernest Koliqi fton për ta lypur hijeshinë e kumbueshmërinë e gjuhës në popull, e cila buron kryesisht nga Malësia jonë e Madhe me rrethinë bashkë me qytetin e Shkodrës e hapësira të tjera gjithsesi veriore e geqe"*.<sup>32</sup>

"Hija e maleve" nis me tregimin Nusja e mrekullueshme, e cila vë në pah mentalitetin tipik shqiptar, bestytnitë mitike, të cilat mbase edhe janë konsumuar në ngjarje të vërteta në shoqërinë e kohës. Ngjarjet, të cilat lidhen me tragjicitetin, që e pëson Leka si pasojë e dashurisë, që qon me nusen e mrekullueshme Zanën, e cila i shfaqet gjatë kohës kur ky po kulloste bagëtitë ia rrëfen prifti i fshatit Don Marku të riut intelektual, që ishte shkolluar jashtë Shqipërisë.

Ngjarjet, që tregon prifti në rrëfimin e tij në lidhje me tragjiken, që pëson Leka në psikikën e të riut shqiptar të shkolluar në një metropol evropian ngritin dilema të mëdha dhe në njërin, ose mënyrën tjetër edhe pse si personalitet ishte "formuar" larg ambientit, i cili këto e rrëfime të ngjashme i konsumonte si gjëra të vërteta, që kishin lënë përshtypje të thella tek i riu intelektual.

<sup>29</sup> Ernest Koliqi, *Ese të letërsisë shqipe*, Botimet IDK, Kumi, 2005, fq.19

<sup>30</sup> Arben Hoxha, *Poetikë e prozës së Ernest Koliqit*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, fq.182

<sup>31</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Maluka, Tiranë, 2009, fq.351

<sup>32</sup> Gjovalin Shkurtaj, *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë, 2009, fq.120

Novela Gjaku në qendër të saj e ka temën e hakmarrjes, e cila realizohet nëpërmjet mësuesit Dodë, i cili ishte kundër hakmarrjes, mirëpo në fund zbulohet se përkundër asaj, që Doda ka marrë dije e ide të reja, prapë në thellësitë dhe errësitë e tij shpirtërore, rri një kulturë jetësore e ambientit, e cila fle po mund të zgjohet nëse preket në themelet e saj. *"Njësimi shpirtëror e kulturor i botës shqiptare është i domosdoshëm, sipas Koliqit edhe për një arsye tjetër për të kapërcyer prapambetjen relative të kombit shqiptar dhe për të fituar përpjekje të gjithanshme kohën e humbur, duke mundësuar kështu pas një kohe ecjen krah për krah me kombet e tjera të qytetëruara"*.<sup>33</sup>

Në tregimin Kanga e re personazhi kryesor është Ton Lasku, i cili nga një djalosh, që çdo ditë i ndërronte mendimet lidhur me femrat filloj të ndryshonte. Ai tani me të vërtetë ra në dashuri, por hoqi shumë derisa e bëri për vete vajzën, që i pëlqente. Në tregimin Se qofsh, pleqnofsh vihet në pah mentaliteti i ashpër i botës shqiptare, sepse për shqiptarët nderi i familjes është gjëja më e rëndësishme, po të njolloset nderi i një shtëpije, atëherë shqiptari është në gjendje të vrasë edhe fëmijën e vet.

Kështu ka vepruar Sufa, i cili vrau të bijën Minen, pa menduar fare kur mori vesh, se ajo ka pasur lidhje me një djalë, mirëpo siç vepron shumica e vajzave malësore, ashtu veproj edhe Mina duke mos treguar emrin e atij me të cilin ishte në lidhje. Arsyeja, që nuk e tregoj emrin e të dashurit ishte, se ajo me të gëzoj disa ditë dashurie, por arsyeja kryesore, që nuk e tregoj emrin ishte të parandalonte vrasjen e tij nga babai i saj. *"Ernest Koliqi di të hyjë në thellësinë e ndjenjave shekullgjatë të popullit, di si t'i analizojë e pikturojë, e të jetë analist i aftë emocionesh e gjendjesh të ndryshme shpirtërore"*.<sup>34</sup>

Tregimi Kërcimtarja e Dukagjinit është një tregim në mes të përrallës dhe legjendës. *"Mrekullia është përtej jetës reale në përrallë, kurse kjo është ushqim shpirtëror që synon e arrin mrekullinë"*.<sup>35</sup> Tregimi Miku tregon se shqiptarët në plan të parë e kanë mikpritjen edhe në rastet kur mysafiri i tyre mund të jetë ai, i cili ka vlarë dikënd prej familjes së tyre, mirëpo edhe armiku kur të vijë në shtëpi, atëherë edhe atë duhet ta presësh, si më të shtrenjtin dashamirë.

Kështu ka vepruar Uc Lleshi, i cili priti në shtëpinë e tij vrasësin e të vëllaut Gjokë Vatën dhe shpëtoj nga autoritetet gazetarin Shefqet Kadija. Personazhi kryesor në tregimin Andërr e një mbasditje vere është zonjushë Neta, e cila kishte një zë të bukur dhe këndonte këngë të bukura shkodrane. Në tregimin Kur orët lajmojnë e kuptojmë, që bestytnitë janë të ngulitura thellë në mendjen e shqiptarëve, sepse nëse beson në to, atëherë ato mund të bëhen realitet.

Kështu i ndodhi Lulash Prelës, i cili besonte, se orët e lajmëronin vdekjen e tij, apo të Gjeto Markut. *"Duke na zbuluar më së miri anë të ndryshme të mendësisë së popullit, të psikologjisë së tij, na zbulon të kaluarën e tij rrugët nëpër, të cilat ka ecur në rrjedhën e gjatë të shekujve"*.<sup>36</sup> Në tregimin Kopshti personazhi Shuk Dila, pas një kohe shumë të gjatë njihet me shoqen e fëmijërisë, Dushën.

Në tregimin Ke tre lisat dashuria e madhe në mes të Mrikës dhe Gacit shndërrohet në hakmarrje, pasi Mrikës ia vrau kushëririn i vëllau i Gacit, Palushi. Në tregimin Diloca autori trajton jetën në Malësi e në Shkodër. Ky tregim është shkruar në trajtën e dëshmisë së një ditari dhe përbëhet nga 15 pjesë, që nisin me 17 janar dhe përfundojnë më 10 prill. *"Me të na kthehet e panjollë ajo pjesë Shkodre dhe Shqipërie që poeti e mori me vete ashtu siç ishte përshkruar tek "Hija e maleve"*.<sup>37</sup>

<sup>33</sup> Enver Muhametaj, Ndhimesa të Ernest Koliqit në mendime teoriko-letrar shqiptar, Tiranë, 2008, fq.59

<sup>34</sup> Laura Smaqi, Receptimi i veprës së Ernest Koliqit në vitet 30, SF, nr. 3-4, 1998, fq.73

<sup>35</sup> Sabri Hamiti, Vepra letrare 8, Letërsia moderne, Prishtinë, 2002, fq.590

<sup>36</sup> Mark Tirta, Mitologjia ndër shqiptarë, Tiranë, 2004, fq.392

<sup>37</sup> Dhurata Shehri, Koliqi mes malit dhe detit, Onufri, Tiranë, 2006, fq.5

Ernest Koliqi është shkrimtari, i cili depërton thellë në mendjen e intelektualëve, që janë shkolluar jashtë vendit, por që janë rikthyer në atdhe për të kontribuar në vendin e tyre me dijen dhe kulturën, që e kanë marrë jashtë vendit. Intelektuali i rikthyer në Shqipëri bën përpjekje të vazhdueshme për t'i larguar zakonet e vrazhda, por në anën tjetër duke u munduar t'i ruajë me fanatizëm të madh ato tradita dhe zakone, që ja vlen t'i bartim brez pas brezi, ndërsa intelektuali tjetër, i cili jeton jashtë Shqipërisë është duke e dhënë maksimumin e tij për t'i ruajtur zakonet dhe traditat e vendit të tij nga asimilimi, sepse duke qenë çdo ditë në kontakt me një mentalitet tjetër, ndryshe nga ai i vendit të tij do të ketë shumë mundësi, që t'i harroj traditat dhe zakonet e prejardhjes së tij.

Ernest Koliqi në novelën Gjaku nëpërmjet personazhit të tij mundohet të ndërrojë mentalitetin shqiptar, i cili është ngulitur thellë në mendjen dhe zemrën e tyre. *“Kryeheroi i quajtur Dodë, i ka vënë vetës për qëllim misionin e njeriut që në gjirin e njerëzve të tij do të përhapë qytetnimin”*.<sup>38</sup> Në këtë novelë e kemi personazh Dodën, i cili përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të ndryshuar mentalitetin e prapambetur të vendit të tij, prapë nuk ka mundësi, që t'i ikë kanunit, përkundër asaj, që ai kanunin e sheh, si një ligj të ashpër të së kaluarës, por i cili vazhdon të respektohet shumë nga kolektivi.

*“Siç tregon simbolikisht edhe vetë titulli “Gjaku” kemi të bëjmë me gjakun, bajrakun, kanunin e të themi mitin e palcës etnike shqiptare”*.<sup>39</sup> Intelektuali bie pre e rrethit të tij edhe pse ishte shkolluar me qëllimin, që t'i nxjerrë popullin e tij në dritë dhe të shohin pak më larg se kanunin e tyre, që të emancipoheshin, por pas vrasjes së vëllaut Doda ndryshe mendonte e ndryshe vepronte, por prej tij gjithë kërkojnë të vrasë, prandaj sado mundohet t'i ikë kanunit, prapë i dëgjon zërat, që duhet të hakmerret dhe kur vret shprehet me fjalët: “S’due me ikë” sepse është i vetëdijshëm çfarë ka bërë, por tash është më i qetë, sepse është liruar nga barra për të marr hakun, por me këtë vrasje e ka vrarë gjithë shkollimin e tij, që e ka marr jashtë vendit, me një fjalë ai vret gjithë kulturën, që kishte marr, po ashtu e vret një të ardhme të ndritur, që mund ta kishte për veten dhe familjen e tij për të cilën kishte punuar aq shumë dhe nuk arriti ta gëzonte.

*“Doda “vetëvritet”, jo në favor të çlirimit nga trauma e lindur në atmosferën dhe erën e gjakut që vjen nga bota ku ai qarkullon”*.<sup>40</sup> Doda është personazhi, të cilin e goditi rëndë vrasja e vëllaut me vrasjen e, të cilit çdo gjë për të ka marrë fund, por ai vret atë, që ja vrau vëllaun, por me këtë rast ai shndërrohet në vrasës të imponuar nga presioni, që i bënte rrethi i tij, prandaj me këtë veprim ai ka vrarë edhe veten e tij. Ky është një mentalitet i vrazhdë, i cili i ka lënë shqiptarët shumë pas në kohë. Në këtë novelë tema kryesore është hakmarrja, pra marrja e gjakut. *“Pushka e çon gjakun te shpija” dhe “Gjaku shkon për gisht”*.<sup>41</sup>

Protagonisti kryesor është kundër hakmarrjes, sepse është njeriu i shkolluar, i cili ka marr mësim brenda dhe jashtë vendit. Ky njeri i shkolluar me origjinë është malësor, por dallon shumë nga bashkëvendasit e tij, jo vetëm sa i përket shkollimit, por edhe shumë gjërave të tjera sa i përket jetës. Profesionin e tij është mësues. Është mësuesi Dodë, një intelektual shumë i zoti. Novela Gjaku fillon me programin e protagonistit Dodës, program që shtrohet nëpërmjet një pyetje aprovuese: - *“A ka send ma të mrekullueshëm në këto botë se me e sjell qytetnimin një kombi zhytë n'errsin e padijes”*.<sup>42</sup>

Kjo është një pyetje, të cilës Doda do të mundohet t'i qëndroj besnik deri në fund, por edhe ky bie viktimë e këtij kombi zhytë në errësinë e padijes. Doda këtë pyetje ia shtron vetes, dashnores së vetë shkodrane Nushës, e përmes tij autori ua shtron lexuesve.

<sup>38</sup> Kujtim Rrahmani, Intertekstualiteti dhe oraliteti, E.Koliqi, M.Kuteli, A.Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, fq.110

<sup>39</sup> Nysret Krasniqi, Epistemë letrare, AIKD, Tiranë, 2010, fq.74

<sup>40</sup> Kujtim Rrahmani, vepër e cituar, fq.111

<sup>41</sup> Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1993, fq.147

<sup>42</sup> Ernest Koliqi, “Hija e maleve”, Buzuku, Prishtinë, 2003, fq.24

Ai dëshiron që dijen, të cilën e ka marrë brenda dhe jashtë vendit ta përcjellë tek shoqëria shqiptare, prandaj mendon se vetëm mësimi është faktori kryesor, i cili mund të ndryshojë për të mirë botën shqiptare, në të kundërtën ata vetëm do të vazhdojnë të mbesin në errësirën, e cila i ka mbuluar me shekuj. Atë e çudit fakti, se pse fëmijët qysh në vegjëli rriten me ndjenjën e hakmarrjes dhe të besës.

Më mirë do të ishte, që hakmarrja të mos vazhdojë, sepse kur vazhdon, atëherë do të shkojë deri në atë masë, që dyert e atyre shtëpive, të cilat janë në gjak të mbyllen përgjithmonë, sepse vrasjet do të vazhdojnë njëra pas tjetrës. Është shumë interesante pyetja që i bën e dashura: - *"Ça do me ba ti për me ia shkullë rranjët të parave e me zhdvillue të dytat"*?

Ai i përgjigjet: - *"Ça ban ma tepër përshtypje në trut e njoma të foshnjevët, në vjetët e para të shkollës? Libri i leximit; as? - Pra un kam qitë cekën me përpilue një liber leximi, pesë vëllimesh - Aqë sa janë klasët e shkollës fillore, - ku metodikisht, me tregime të gjalla, do t'orvatem të zhvilloj një ideal jete vërtet shqiptare, bazue mbi prirje të mira qi trashiguem nga të parët. Natyrisht aty prirjet e këqija do t'i stigmatizoj në një mënyrë qi të mbesë e pashlyeshme në trut e ..."*<sup>43</sup>

Doda është shumë i vendosur në këtë që e thotë, por a do ta realizoj atë që e thotë? Kjo është një pyetje, përgjigjen e, së cilës do ta marrim në fund të novelës. Në fillim e kuptojmë, që Doda është i fejuar me Nushën, e cila e kishte vetëm nënën, ndërsa i ati i kishte vdekur. Doda i thotë Drandes (nënës së Nushës), që të fillojë me përgatitjet e dasmës, por a do të ndodhë dasma? Doda dhe Nusha ishin shumë të lumtur, por lumturia e tyre do të kthehet në trishtim kur atij i vjen lajmi për vrasjen e vëllaut Zekës.

Këtë lajm të hidhur ia sjelli një mik i shtëpisë së tyre kur Doda po bënte plane, që do të kishte një jetë të lumtur, të cilën nuk kishin pas rastin ta jetonin malësorët e tij, po në mëngjesin e asaj dite vëllaun ia kishin vrasur Fetejt, armiq të tyre të vjetër. Ai qëndroj në Malësi, derisa përfundoj e pamja e vëllaut, ishte shumë i hutuar, i frikësohej më të keqes, asaj kundër së cilës ishte, pra hakmarrjes. Njeriu, i cili mendohej t'i ikte hakmarrjes dhe çdo gjë ta linte në duart e autoriteteve.

Doda u këthye në Shkodër, por tani asgjë nuk kishte rëndësi për të. Kishte filluar t'i tretej dashuria për Nushën, ndërsa orët e mësimin nuk i sjellnin më gëzim, por i dukeshin shumë të gjata dhe monotone. Atij i bënte presion rrethi, që të merrte gjakun e në veçanti i bënte presion Marku. Ai i thoshte nëse nuk dëshiron ta vrasësh me dorën tënde, atëherë ka njerëz, që mund ta vrasin, pra ta marrësh gjakun nëpërmjet njerëzve të tjerë. Doda nuk ishte më mësuesi, i cili filloj të shkruante librin.

Ai kur u këthye në Shkodër nuk u muar më me librin, por filloj të pinte, pra ka mbetur mes dy zjarreve. Si mund të vrasë një njeri, i cili ka qenë kundër hakmarrjes, por në anën tjetër, si mund të jetojë një njeri pa e marr gjakun e vëllaut? Këto janë dy pyetje, që secili prej nesh ia shtron vetvetes, prandaj Doda bisedon me shumë njerëz për këtë çështje, siç janë: Nusha, nëna e Nushës, prifti, por bisedat, që i bënte me ta nuk i ndihmonin asgjë, por vetëm e nervozonin. Doda ishte në shkollë kur Marku (kushëriri i tij), e lajmëroj se ku mund ta gjente njeriun, i cili i kishte vrasur vëllanë.

Ai kur e pa Nikë Fetën *"Gjasht të krisme revoleje kumbuen. Nikë Feta u përplas për tokë tue qitë gjak gjithkah"*.<sup>44</sup> Doda, i cili ka marr gjakun e vëllaut ndihej më i lehtësuar gjë, e cila shprehej në këtë mënyrë: *"Valavitej përmbrenda, në një kaos të pështjellueshëm ndiesish. Vetëm, në fund të shpirtit, diçka lehtësohej: ish si një ndiesi e paçansueshme liri. Por s'ishte i zoti me mendue: as nuk donte"*.<sup>45</sup>

<sup>43</sup> Po aty, fq.29

<sup>44</sup> Po aty, fq.58

<sup>45</sup> Po aty, fq.59

Protagonisti kryesor, i cili ishte kundër hakmarrjes në fund doli, se ishte sikur malësorët e tij, sepse thellë në shpirtin e tij ishte e ngulitur jeta e tij malësore. *"Njeriu përfilllet prej psikanalizës si një shndërrim, si një qenie që projekton të ardhmen: mes erosit (dashurisë) dhe thanatosit (vdekjes)."*<sup>46</sup>

Në këtë tregim mund ta vërejmë një raport shumë të afërt në mes të letërsisë, e cila qëndron në një lidhje shumë të ngushtë me psikologjinë. Psikologjia është shkenca, e cila studion sjelljet e qenieve njerëzore dhe marrëdhëniet e tyre psiko-sociale, prandaj Koliqi është një ndër njohësit më të mirë të psikikës njerëzore, i cili i njeh shumë mirë traditat dhe zakonet e shqiptarëve. Ai i njeh shumë mirë njerëzit e vendlindjes së tij, të cilëve ua di sakrificat, ëndrrat, vuajtjet dhe dëshirat e tyre të ndrydhura ndër shekuj.

Sipas, Frojdit i kemi tri shtresa shpirtërore të brendshme, siç janë: idi, egoja dhe super egoja. Idi është shtresa e pavetëdijshme animale, përfaqëson anën biologjike, aty njeriu është kafshë. Egoja (uni), përfaqëson anën shpirtërore emocionale dhe super egoja shpreh anën shoqërore e sociale. Idi paraqet pjesën e parë të ditshme, egoja pjesën e pavetëdijshme, kurse super egoja pjesën e vetëdijshme. Idi është i lidhur drejtpërdrejtë me instikte, egoja i kontrollon dhe i frenon ato, kurse super egoja largon funksionin e gjykimit kritik. Veprimet e njeriut, sipas Frojdit i diktojnë veprimet e pavetëdijshme, të cilat janë të strukshme në ndërdijen e tij.

Nga momenti, që ja vrasin vëllaun e deri në momentin kur e realizon hakmarrjen përballemi me unin e Dodës, mësuesit, e cila është rezultat i idit pavetëdijes personale, sipas Frojdit e të shoqëruar me një pjesë të pavetëdijes kolektive, sipas Jungut, ndërsa super egoja është sistem i brendshëm, që ka për qëllim të shtypë me dhunë, ku nëpërmjet kësaj shtypjeje të brendshme personazhi Dodë arrin t'i ndëshkoj autoritetet, përfaqësuesit kryesor të rendit dhe të vendit të tij.

Fajtor për këtë nuk është ai, por rrethi, i cili bëri presion të madh mbi të, por në anën tjetër fajtor janë autoritetet, sepse po të merreshin autoritetet me vrasjet, që ndodhnin në atë kohë hakmarrjet do të pushonin dhe nuk do të ndodhnin vrasjet njëra pas tjetrës. *"Për të arti dhe letërsia është një grishje e mistershme drejt gjurmimit të shpirtit të fshehtë të sendeve. Në këtë mënyrë ai prezanton në veprën e tij edhe elemente psikanalize, psikanalizë ndoshta jo si njohje e drejtpërdrejtë e mësimeve të Frojdit, por si praktikë e imponuar individuale dhe si informacion i marrë në mënyra të tërthorta".*<sup>47</sup>

## **Përfundime**

Me zhvillimin e rrjetit global, interneti ka zënë një vend të veçantë sa i përket burimeve të informacionit. Ardhja e krizës ekonomike globale, ka bërë që blerja e materialeve të shtypura të kalojë në leximin e botimeve në internet. Kërkimet që dikur bëheshin me ditë në rafte ose dhomat e periodikëve nëpër biblioteka, tani mund të bëhen brenda disa minutash. Nga disa kërkime të shpejta në Google, në lidhje me librat dhe informacionet që na nevojiten, ne i gjejmë faktet dhe citimet-referencat për hulumtimet tona shkencore.

Autori, vepra, ka qenë shumë e vështirë si rrugë deri te leximi, por sot me zhvillimet që ka sjellë për industrinë e librit progresi i vrullshëm i teknologjisë dhe platformave online, vërejmë se kurrë ndonjëherë libri nuk ka pasur kaq shumë mundësi ekspozimi, nëse përfillim si të tillë dhe ekspozimin në rrjetet virtuale. Në vend të leximit tradicional të vepres, tanimë gjeneratat e reja kanë kaluar prej kohësh te kompjuteri, arsyeja është shpejtësia dhe lehtësimi, ku u duhen disa sekonda deri në një minutë për të kërkuar informacionin e nevojshëm.

Kompjuteri është sot i pranishëm pothuajse në çdo shtëpi, kjo po mundëson lexuesve të fokusohen në pjesë të izoluara të tekstit, por jo edhe tekste, vepra me informacion dhe kuptim të qartë. Sipas studimeve që janë bërë shohim se sa më shumë kohë një përdorues shpenzon në internet, aq më pak përdor burimet tradicionale për të marrë lajme.

<sup>46</sup> Aurel Plasari, Qasja e tregimit të Koliqit, Nëntori, nr. 3, 1991, fq.105

<sup>47</sup> Stefan Çapaliku, Studime shqiptare 3, Ernest Koliqi, Universiteti i Shkodrës, fq.19

## Referencat

1. Ernest Koliqi, Ese të letërsisë shqipe, Botimet IDK, Kumi, 2005
2. Arben Hoxha, Poetikë e prozës së Ernest Koliqit, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005
3. Mc.Luhan, Marshall, The Gutenberg Galaxy, University of Toronto Press, Printed in Canada, Reprinted, 1962
4. Sabri Hamiti, Letërsia moderne shqipe, Maluka, Tiranë, 2009
5. Gjovalin Shkurtaç, Pësia e fjalës shqipe, Tiranë, 2009
6. Enver Muhametaj, Ndhimesa të Ernest Koliqit në mendime teoriko-letrar shqiptar, Tiranë, 2008
7. Laura Smaçi, Receptimi i veprës së Ernest Koliqit në vitet 30, SF, nr. 3-4, 1998
8. Sabri Hamiti, Vepra letrare 8, Letërsia moderne, Prishtinë, 2002
9. Mark Tirta, Mitologjia ndër shqiptarë, Tiranë, 2004
10. Dhurata Shehri, Koliqi mes malit dhe detit, Onufri, Tiranë, 2006
11. Kujtim Rrahmani, Intertekstualiteti dhe oraliteti, E.Koliqi, M.Kuteli, A.Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002
12. Nysret Krasniqi, Epistemë letrare, AIKD, Tiranë, 2010
13. Shtjefën Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1993
14. Ernest Koliqi, "Hija e maleve", Buzuku, Prishtinë, 2003
15. Aurel Plasari, Qasja e tregimit të Koliqit, Nëntori, nr. 3, 1991
16. Stefan Çapaliku, Studime shqiptare 3, Ernest Koliqi, Universiteti i Shkodrës.